



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:176248

Datë: 17.01.2025

Numri i dokumentit: 06724520

ARJ.nr.130/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Milena Djerić dhe Beshir Islami anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit I. K., nga D., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Heset Mazrekaj, avokat nga Prishtina, lagjja Qëndresa, „Rr.”....., kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM SHCK), dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me bazë juridike anulimin e aktit administrativ - vendimit A.nr.351/2019 të datës 21.07.2022, të KPM SHCK, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, të ushtruar nga i autorizuari i lartë cekur, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.744/2023 të datës 12.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15 Janar 2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e ushtruar nga paditësi I.K., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.744/2023 të datës 12.07.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AA.nr.744/2023 të datës 12.07.2024, është vendosur si në vijim: **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit I.K., e datës 27.09.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2102/2016, i datës 05.09.2023, **VËRTETOHET**.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe shkeljes së të drejtës materiale, me propozim që, I. APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e paditësit, II. NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, AA.nr.744/2023 të datës 12.07.2024, ose III. ANULOHET aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i padituri Këshilli i Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me vendimin A.nr.351/2019 të datës 21.07.2022, ka vendosur si në vijim: REFUZOHET si e pabazuar ankesa, A.nr.351/2019 e datës 21.06.2019, e parashtruar nga ankuesi I.K., II. Shfuqizohet Vendimi i datës 24.05.2019, me numër protokolli I.GJA.nr.1/2019-74, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, si dhe vendimi i datës 08.04.2019, me numër protokolli GJA.nr.1/2019-63, i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren.

Kundër aktit të lartë cekur të KPMSHCK paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin A.nr.2102/2022 të datës 05.09.2023, ka vendosur si në vijim: REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpapia e paditësit me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit A.nr.351/2019 datë 21.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe të detyrohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës që paditësit në bazë të nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës t'ia kompensoj pagat jubilarë dhe ato përcjellëse me rastin e pensionimit si dhe diferencën e pagës për muajin Maj të vitit 2016, me rastin e pensionimit, respektivisht shumën e përgjithshme prej 2,415.64 euro.

Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera thekson se: Nga shkresat e lëndës këtu paditësi nuk ka dëshmuar se i njëjti ka iniciuar procedurë gjyqësorë lidhur me vendimin e datës 28.11.2020 A.nr.47/2018 me të cilin zbatohen aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit. Kurse nga njoftimi i datës 13.01.2021 këtu paditësi njofton KPMSHCK se vendimi i Këshillit A.nr.47/2018 datë 28.11.2020, nuk është ekzekutuar deri tani, duke kërkuar nga KPMSHCK të konfirmon se vendimi i datës 05.09.2016 është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm në mënyrë që i njëjti të ketë titull ekzekutiv në pajtim me normat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore. Po ashtu nga shkresat e lëndës konstatohet se këtu paditësi në raport me vendimin e datës 28.11.2020 me të cilin janë zbatuar vendimet gjyqësorë nuk ka iniciuar procedurë gjyqësorë lidhur me atakimin e të njëjti, apo iniciimin e procedurave në ekzekutimin e të njëjtit, por se nga vendimi i datës 08.04.2019 konstatohet se i njëjti ka iniciuar kërkesën për paga jubilarë dhe se me vendimi i datës 24.05.2019 konstatohet se ka iniciuar ankesë ndaj vendimit të datës 08.04.2019, nga vendimi i datës 24.05.2019 konstatohet se refuzohet ankesa e datës 08.04.2019 dhe se me njoftimin e datës 30.08.2019 është njoftuar se KPMSHCK është jofunksional lidhur me ankesën e datës 21.06.2019, kurse me aktgjykim A.nr.2323/2019 datë 18.05.2022 detyrohet e paditura në vendosje sipas ankesës së datës 21.06.2019.

Tutje theksohet se, paditësi fillimisht ka iniciuar procedurën referuar periudhës së vitit 2016 deri në vendimet gjyqësorë të cilat nuk e kanë vendosur çështjen në merita, dhe se ndaj të njëjtave ka iniciuar propozimin për përmbartim, kurse ndaj vendimit të paditurës për zbatim e aktgjykimeve të gjykatës i njëjti nuk e ka atakuar këtë vendim apo dhe të kërkoj zbatimin e tij lidhur me pagat

përcjellës, andaj tani si e tillë kërkesa për pagë përcjellës në gjykatë është e pabazuar fillimisht se nuk mund të inicioj procedurë gjyqësore tani përderisa lidhur me aktin administrativ përfundimtar në procedurë administrative lidhur me po këtë kërkesë është vendosur me vendim përfundimtar me datë 28.11.2020, kurse tani me padinë e datës 29.08.2022 nuk mund ti referohet kësaj kërkesës për pagat përcjellëse përderisa referuar vendimit të datës 28.11.2020 nuk ka ndërmarrë veprimet përkatëse qoftë për atakimin e të njëjtit nëse ishte i pakënaqur apo me ekzekutimin e tij në rast se i njëjti vendim ishte i favorshëm për paditësin në kuptim të nenit 23 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil ku përcaktohet: *“7. Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e kalimit të afatit për zbatim të vendimit të Këshillit, pala mund të fillojë procedurën e përmbarimit të vendimit të Këshillit në gjykatën kompetente, në pajtim me dispozitat e ligjit për procedurën përmbarimore”*, por se i njëjti përsëri me ankesën e datës 26.04.2019 inicion procedurë lidhur me kompensimin me rastin e pensionimit - paga jubilarë në shumë prej 1,708.68 euro, andaj fillimisht gjykata konstaton se paditësi lidhur me kërkesën e tij nuk ka ndjekur procedurë ligjore në raport me pagat përcjellëse ashtu siç është arsyetuar në këtë vendim, kurse në raport me kërkesën për kompensimin jubilar Gjykata kishte parasysh Marrëveshjen Kolektive neni 52 ku përcaktohet: *“1. I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. 3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*, kurse në nenin 53 është përcaktuar se *“I punësuari me rastin e pensionimit gëzon të drejtën në pagën përcjellëse në lartësi prej tre (3) paga mujore që i ka marr për tre(3) muajt e fundit”*. Me nenin 90 par.4 të Ligjit të Punës është e përcaktuar *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”*.

Gjykata e shkallës së parë vlerëson se në rastin e paditësit, nga shkresat e lëndës është jokontestuese fakti se paditësi ka dal në pension më datë 21.05.2016, bazuar në vendimin nr.9/19, referohet periudha e punës së këtij paditësit, nga 01.02.2001-21.05.2016, kurse nga akt emërimi datë 27.12.2012 në shkresat e lëndës këtij paditësi ka themeluar marrëdhënie pune pranë Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Dragash me datë fillimi 01.01.2013, i cili akt emërim Gjykatës i është dorëzuar gjysmak-jo i kompletuar, nuk ka nënshkrim të palëve në këtë akt emërim, andaj mbi vërtetimit të datës 9/2019 bazuar në arritjen e periudhës së viti jubilar kërkesa nuk referohet bazuar në afatin tre vjeçar nga momenti i kalimit të një muaji nga lindja e kërkesë dhe po ashtu viti jubilar është arritur kur marrëveshja kolektive nuk ka fuqi juridike, kjo për faktin se përvoja e referuar sipas vërtetimit 9/2019, përshkruhet për periudhën 01.02.2001-21.05.2016, andaj gjykata refuzoi kërkesën e paditësit pasi gjykata gjeti se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka hyrë në fuqi nga 01.01.2015 dhe në nenin 52 dhe 53 të kësaj marrëveshje është paraparë shpërblimi jubilar dhe pagat përcjellëse, ndërsa paditësi vitin jubilar e ka arritur në periudhën kur Marrëveshja e Përgjithshme Juridike nuk ishte në fuqi.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që i njëjti të anulohet dhe çështjen t'ia kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësi. Andaj kjo gjykatë vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, neni 200 të LPK-së, lidhur me nenin 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Në arsyetim tutje theksohet se, pretendimet e paditësit janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, sepse paditësi nuk ka arritur vitin jubilar gjatë kohës sa ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive dhe si e tillë nuk i takon shpërblimi jubilar. Andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar, shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vepruar me refuzimin si të pabazuar të ankesës së paditësit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuar nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuar përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadisë së paditësit.

Theksimet në kërkesë, lidhur me kontestimin e vendimeve të organit të paditur dhe aktgjykimet e gjykatave të instancave të ulëta në mënyrë kronologjike, duke bërë përshkrimin e tyre sipas mënyrës së vendosjes, të cilët i konteston si jo të drejtë dhe ligjor si dhe pretendimet e përmbledhura ku ndër të tjera thekson se, nuk mund të jenë të qëndrueshme konstatimet e gjykatave më të ulëta se paditësi nuk ka ndërmarrë veprime përkatëse lidhur me atakimin në afatin e lejuar të vendimeve të organit punëdhënës sepse këtë e ka bërë sipas afateve, se është jo e justifikueshme që dy herë në procedurë gjyqësore ti jenë aprovuar paditë dhe janë anuluar vendimet e organit të paditur për tu aplikuar normat e nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes Kolektive, ndërsa tani me vendimin e KPMSHC dhe gjykatave të instancave më të ulëta vendosin në mënyrë të kundërt, se nuk ka kërkuar pagën e fundit jubilarë por tri paga me që kishte mbi 30 vite përvojë pune ,andaj sipas dispozitave të LMD, parashkrimi nuk rrjedh duke patur parasysh se paditësi është pensionuar me dt. 21.05.2016, dhe brenda afatit ka paraqitur kërkesë për pagesë të pagave jubilarë dhe atyre përcjellëse në bazë Marrëveshjes Kolektive andaj aktgjykimi i goditur nuk është

arsyetuar mjaftueshëm si në kuptim të nenit 160 të LPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme këto pretendime dhe të tjera në këtë drejtim i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe vlerëson se nuk janë të qëndrueshme dhe të bazuar sepse nga vendimi organit të paditur si dhe aktgjykimet e instancave më të ulëta provohet se ankesa e palës ankuese nga i padituri KPMSHC me vendimin A/02/288/2016, të dt. 16.05.2016, ishte aprovuar duke ju njohur e drejta në një pagë mujore në vlerën e pagës së fundit të pranuar pas arritjes së moshës së pensionimit, bazuar në Ligjin për Paga të Shërbyeseve civil. Pala paditëse këtë vendim nuk e kishte kontestuar me padi në konflikt administrativ si parashihet me ligj, edhe pse në këtë vendim ishte shqyrtuar dhe përmbyllur edhe kërkesa e tij për tri pagat e kërkuara me rastin e pensionimit, me këtë kishte lëshuar afatet ligjore për kontestimin në procedurë gjyqësore të çështjes së tij. Paditësi me 27.03.2019 ushtron kërkesë të re të përsëritur, Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren për të i'u njohur e drejta në tri paga përcjellëse pas pensionimit dhe paga jubilarë, për deri sa në këtë periudhë nuk ishte në fuqi Marrëveshja Kolektive e cila nuk kishte veprim retroaktiv, dhe përvoja e punës sipas vërtetimit 9/2019, nuk përputhej me vitin jubilar të cilin e mbulonte Marrëveshja Kolektive, e arsyetuar në tërësi si në faqen 6-7, të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të cilin arsyetim, të përsëritur në tërësi si gjykata e shkallës së dytë, e aprovon si të drejtë dhe ligjor edhe Gjykata Supreme, me që paditësi kishte bërë propozime jo ligjor për përmbarim të aktgjykimeve të gjykatave të instancave më të ulëta sipas të cilëve nuk kishte vendosje meritore të çështjes por çështja e ngritur nga paditësi ishte kthyer në rishqyrtim tek i padituri KPMSHCK, për deri sa kundër vendimeve përfundimtare të paditurit nuk kishte iniciuar procedurë për ekzekutimin e të njëjtëve apo atakimin e tyre në procedurë gjyqësore.

Gjykata shqyrtoi pretendimet e tjera si në kërkesë, por vlerësoj se të njëjtat janë të përsëritura, të shqyrtuara nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara dhe jo të qëndrueshme apo me ndikim për vendosjen ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta. Gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë, i cili është i qartë, i kuptueshëm dhe i arsyetuar mjaftueshëm në faktet vendimtare sipas mënyrës së vendosjes. Në këtë çështje edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1, të Ligjit për Konflikte Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.130/2024, më datë 15 Janar 2025

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani